

VENDIM
Nr. 495, datë 30.7.2021

**PËR KALIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, TË PASURISË NR. 1/241,
TË LLOJIT “TRUALL”, NË ZONËN KADASTRALE 8150, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të shkronjës “d”, të nenit 3, dhe të neneve 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/241, lloji “truall”, në zonën kadastrale 8150, Tiranë, me sipërfaqe totale 5 522.7 (pesë mijë e pesëqind e njëzet e dy pikë shtatë) m², me adresë: rruga “S. Toptani”, Tiranë, sipas kartelës së pasurisë dhe fragmentit të hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t’ua japë të tretëve në përdorim.

3. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, miratuar me vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 8150

KODI UNIK: 8150030040

NUMRI PASURISË: 1/241

INDEKSI HARTËS: TR-P-12

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8150030040
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8150, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 1/241, Sipërfaqja Totale 5522.7 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale TR-P-12, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia TIRANË, Rruga S.TOPTANI, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti
Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare _____ Leke (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT 00000SHTET, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia ÇLIRIM, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 00032988, Datë: 30/07/2021

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektivit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkuar	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: _____

DREJTORI
Elira Gogo

Elira
Gogo

Digitally signed by:
Elira Gogo
Date: 2021.07.30
11:43:18 +02'00'

Data e lëshimit 30/07/2021



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Veri
Date: 2021/07/30 11:33:45 +02'00"
J91326001G2021073011333787ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulozuar me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)